

2020

**SISTEMI
KOMBËTAR
STATISTIKOR**

PLANI VJETOR 2020

Për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare
2017-2021

Përmbajtja

I. Hyrje	0
II. Objektivat strategjike	1
III. Përmbajtja e Planit Vjetor 2020	2
3.1 Aktivitetet Statistikore, burimet statistikore dhe institucionet përgjegjëse	2
3.2 Analiza e risqeve dhe problemet e pritshme për kryerjen e aktiviteteve.....	23
IV. Notë shpjeguese për përdorimin e Aneksit 1	25
V. Aneksi 1	26

I. Hyrje

Plani Vjetor 2020 i paraqitet për miratim Kuvendit të Shqipërisë në zbatim të neneve 9 dhe 10 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”. Dokumenti shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përmbushje të objektivave strategjike dhe rezultatet e pritshme të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017.

Mbështetur në pikën 2 të nenit 9 të ligjit për statistikat zyrtare, INSTAT, në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor, është përgjegjës për përgatitjen e Planit Vjetor, për të planifikuar operacionet, burimet dhe rezultatet e pritshme të vitit 2020 si dhe për të përcaktuar përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë institucionalë për sigurimin, mbledhjen, përpunimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Dokumenti paraqet aktivitetet statistikore që do të kryhen nga INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2020, sipas fushave përkatëse statistikore që mbulojnë, shoqëruar me afate dhe periodicitet e zbatimit. Në të njëjtën linjë paraqiten edhe institucionet përgjegjëse për dhënien e informacionit statistikor dhe frekuencën e transmetimit të këtij informacioni. Sipas kërkesave të ligjit për statistikat zyrtare, me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e veprimtarive të parashikuara dhe parandalimi i pengesave të mundshme, dokumenti përmban edhe një analizë të risqeve dhe problemeve të pritshme gjatë vitit 2020.

Plani Vjetor 2020 është në përputhje me dokumentin e ngjashëm i cili aplikohet nga vendet e tjera anëtare të BE-së, mbështetur në nenin 17 të Rregullores (KE) 223/2009 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2009 “Mbi statistikat europiane, e cila shfuqizon Rregulloren (KE, Euroatom), Nr. 1101/2008 të Parlamentit Europain dhe të Këshillit mbi dërgimin e të dhënave, të cilat i nënshtrohen konfidencialitetit statistikor, Zyrës Statistikore të Komuniteteve Europiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97, Mbi Statistikat e Komunitetit dhe Vendimin e Këshillit 89/382/EEC, Euroatom për krijimin e një komisioni mbi programet statistikore të Komuniteteve Europiane”.

Nën cilësinë e koordinatorit të Sistemit Kombëtar Statistikor, INSTAT është institucioni përgjegjës për të monitoruar zbatimin e Planit Vjetor dhe raportimin periodik të tij pranë Këshillit të Statistikave dhe Kuvendit.

Për të rritur transparencën dhe besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, duke synuar njëkohësisht përmbushjen e rekomandimeve të Eurostat, përveç botimit në Fletoren Zyrtare, Plani Vjetor dhe raportet periodike publikohen edhe në faqen zyrtare të INSTAT-it.

II. Objektivat strategjike të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021 dhe aktivitetet zbatuese:

Harmonizimi i kuadrit ligjor atë të BE-së	<ul style="list-style-type: none">•Ngritja dhe forcimi i strukturave koordinuese brenda INSTAT•Zbatimin e standardeve dhe udhëzimeve të dhëna nga Eurostat dhe BE•Pjesëmarrje në proceset e harmonizimit të kornizës ligjore të vendit me atë të <i>Acquis Communautaire</i>, në kuadër të proçeseve integruese.
Përmirësimi i cilësisë statistikore	<ul style="list-style-type: none">•Forcimi i strukturave të cilësisë statistikore brenda INSTAT•Zhvillimi i cilësisë së të dhënave administrative•Rritja e numrit të vrojtimeve statistikore dhe eficiencës•Përshtatja dhe zbatimi i metodologjive statistikore të rekomanduara
Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të strukturave të prodhimit statistikor	<ul style="list-style-type: none">•Aplikimi i sistemeve evropiane të menaxhimit të cilësisë•Përdorimi i metodave moderne në procesin e mbledhjes së të dhënave•Modernizimi i IT për sigurimin e konfidencialitetit statistikor•Aplikimi i metodave moderne të aksesit të përdoruesve
Rritja e rolit të përdoruesve në proceset e aktiviteteve statistikore	<ul style="list-style-type: none">•Përfshirja e grupeve të interesit në proceset e planifikimit dhe zbatimit•Përfshirja e përdoruesve në proceset e trajnimit të statisticienëve•Zgjerimi i gamës së të dhënave në dispozicion të përdoruesve
Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstucional	<ul style="list-style-type: none">•Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve prodhuese brenda dhe jashtë vendit•Forcimi i bashkëpunimit me organizatat kërkimore, shkencore dhe universitetet•Shkëmbimi i eksperiencës së fituar nga stafet në institucionet e tjera të interesuara
Zhvillimi i proceseve të shpërndarjes së statistikave	<ul style="list-style-type: none">•Reduktimi i kohës së proçesimit nga faza e mbledhjes deri tek publikimi i rezultatit përfundimtar•Forcimi i komunikimit me përdoruesit për të kënaqur kërkesat•Aplikimi i teknologjive moderne për publikimin e të dhënave
Zhvillimi i burimeve njerëzore për të rritur kapacitetet profesionale të statisticienëve	<ul style="list-style-type: none">•Zbatimi i strategjisë dhe planeve të trajnimit•Shkëmbimi i njohurive të marra•Rritja e motivimit të punonjësve•Përdorimi i teknikave të reja menaxhuese

III. Përmbajtja e Planit Vjetor 2020

Ligji për statistikat zyrtare, në nenin 10 të tij, parashikon përmbajtjen e Planit Vjetor sipas strukturës si vijon:

1. Lista e aktiviteteve statistikore dhe afatet kohore gjatë vitit;
2. Lista e burimeve statistikore dhe institucioneve përgjegjëse për dhënien e informacionit;
3. Lista e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare;
4. Analiza e risqeve dhe problemet e pritshme për kryerjen e aktiviteteve;
5. Regjistrat statistikore që do të krijohen, zhvillohen ose mirëmbahen;
6. Rishikime të mundshme të Programit të Statistikave Zyrtare.

Censi i Popullsisë dhe Banesave është aktiviteti më i rëndësishëm i vitit pasi do të mundësojë prodhimin e statistikave të disa fushave. Për këtë arsye, për të evidentuar më mirë aktivitetet që lidhen me kryerjen e censit, Plani Vjetor 2020 përmban një seksion të veçantë të këtij aktiviteti madhor.

3.1 Aktivitetet Statistikore, burimet statistikore dhe institucionet përgjegjëse

Lista e aktiviteteve statistikore paraqitet duke ndjekur strukturën e klasifikimit të fushave dhe temave statistikore, të parashikuara në Shtojcën 1 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” si dhe duke ruajtur linjën e klasifikimeve të fushave statistikore e moduleve përkatëse, të përcaktuara në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021. Përfundimisht është bërë për pjesën e Censit të Popullsisë dhe Banesave, si aktivitet madhor dhe specifik, i cili duke mundësuar gjenerimin e të dhënave për disa fusha, lista e aktiviteteve është pasqyruar në një seksion të veçantë të dokumentit.

Fusha 1 “Statistikat demografike dhe sociale” përbëhet nga 9 tema.

Tema 1.1 “Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj”

INSTAT, si institucioni përgjegjës prodhues, parashikon të kryejë aktivitete të fokusuar në tre nëntema: 1.1.1 “Demografi, migracion dhe projeksione”, 1.1.2 “Censi i popullsisë dhe Banesave, Azil-kërkuesit dhe të huajt” dhe 1.1.3 “Statistikat gjinore”. Në lidhje me nëntemën 1.1.1 do të kryhen tre aktivitete statistikore me frekuencë vjetore dhe tremujore. Prodhimi i statistikave të popullsisë, përfshin një sërë treguesish demografikë si lindshmëria, vdekshmëria, dhe prodhimi i statistikave të migracionit të brendshëm e ndërkombëtar. Prodhimi i statistikave të diasporës, shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, përfshin një sërë treguesish demografikë sipas moshës dhe gjinisë. Këta dy aktivitete kryhen me frekuencë vjetore. Ndërkohë, statistikat vitale mbi numrin e lindjeve, vdekjeve dhe shtesa natyrore e popullsisë, do të prodhohen me frekuencë tremujore. Për kryerjen e këtyre aktiviteteve do të përdoren burimet që INSTAT disponon si: Anketa e Forcave të Punës, të dhënat administrative që merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe për plotësimin e informacionit integrohen edhe të dhënat nga burime ndërkombëtare si: EUROSTAT, UNDESA, UNDP, si dhe statistikat pasqyrë nga disa shtete. Në

kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave, nëntema 1.1.2, në vitin 2020 INSTAT parashikon kryerjen e aktiviteteve mbështetëse dhe statistikore, ku më kryesori është puna përgatitore për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave. Gjithashtu, brenda kësaj nënteme do të kryhet nga INSTAT prodhimi i statistikave të azilit dhe të huajve, me frekuencë vjetore, duke përdorur të dhënat administrative të marra nga Ministria e Brendshme dhe Departamenti i Kufirit dhe Migracionit. Statistikat gjinore, sipas nëntemës 1.1.3, do të prodhohen sipas aktivitetit vjetor që do të kryejë INSTAT, duke përdorur të dhënat e tij, Bankës së Shqipërisë, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi popullsinë më 1 Janar, sipas grupmoshës, gjinisë, qarqeve si dhe mbi komponentët e popullsisë: lindshmëria, vdekshmëria, shtesa natyrore e popullsisë, migracioni brendshëm dhe i jashtëm, numri i emigrantëve dhe imigrantëve bazuar në Anketën e Forcave të Punës; Tregues statistikorë të lindshmërisë, vdekshmërisë, martesave dhe divorceve me frekuencë vjetore si dhe numri i lindjeve dhe i vdekjeve (Shtesa Natyrore e Popullsisë) sipas qarqeve me frekuencë tremujore;

Tregues statistikorë të diasporës shqiptare sipas grupmoshës, gjinisë dhe vendit të rezidencës; Tregues statistikorë të projeksioneve të popullsisë sipas grupmoshës dhe gjinisë; Tregues statistikorë mbi azil-kërkuesit dhe të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grupmoshës, gjinisë, motivit të lejes së qëndrimit dhe sipas vendit të origjinës.

Tema 1.2 “Puna dhe Kostot e Punës”

Tema 1.2 përbëhet nga dy nëntema: 1.2.1 “Punësimi dhe Papunësia” dhe 1.2.2 “Kostoja e punës dhe të ardhurat nga puna”. Përgjegjës për prodhimin e statistikave sipas kësaj teme është INSTAT. Për nëntemën e parë, INSTAT do të kryejë dy aktivitete statistikore me frekuencë tremujore: “Anketën Tremujore të Forcave të Punës”, dhe “Prodhimi i të dhënave administrative të Tregut të Punës”. Për prodhimin e statistikave të tregut të punës do të shfrytëzohen të dhënat administrative që do të sigurohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Për nëntemën e dytë, INSTAT do të përfundojë përpunimin dhe analizën e të dhënave e cila do të finalizohet me publikimin e rezultateve të “Anketës së Strukturës së të ardhurave nga Puna” në 2020. Aktiviteti statistikor “Të dhëna administrative mbi pagat”, me frekuencë tremujore dhe vjetore, do të sigurojë publikimin duke përdorur të dhënat administrative të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi forcat e punës, punësimin dhe papunësinë sipas gjinisë, aktivitetit ekonomik, grupprofesioneve, grupmoshave, nivelit arsimor dhe qarqeve; Tregues statistikorë mbi të papunët e regjistruar gjithsej dhe sipas gjinisë, grupmoshave, nivelit arsimor dhe qarqeve, të papunët e regjistruar që përfitojnë pagesë papunësie, të papunët afatgjatë të regjistruar dhe shkalla e papunësisë së regjistruar; Tregues statistikorë mbi strukturën e të ardhurave nga puna për orë pune, mujore dhe vjetore sipas karakteristikave individuale të punonjësve (gjinia, mosha, profesioni, niveli më i lartë arsimor i arritur), dhe punëdhënësit (aktiviteti ekonomik, madhësia dhe pronësia e ndërmarrjes); Tregues statistikorë mbi Pagën orare, mujore dhe vjetore bruto dhe Hendekun gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike, grupprofesioneve; Tregues statistikorë mbi Pagën mesatare mujore për të punësuarit me pagë në

sektorin shtetëror dhe për të gjithë sektorët ekonomikë sipas aktiviteteve ekonomike dhe grupprofesioneve, hendekun gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike dhe grupprofesioneve.

Tema 1.3 “Arsimi dhe trajnimet”

Kjo temë përbëhet nga nëntema 1.3.1 “Arsimi”, e cila përfshin tre aktivitete statistikore me frekuencë vjetore të cilat duhet të përmbushen nga INSTAT: “Statistika të regjistrimeve në arsim”, “Statistika të diplomimeve në arsim” dhe “Shpenzimet e buxhetit të shtetit mbi arsimin publik”. Për dy aktivitetet e para do të shfrytëzohen të dhënat administrative që sigurohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për statistikën sipas aktivitetit të tretë do të shfrytëzohen burimet administrative të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi regjistrimet që llogariten me bazë vjetore, sipas niveleve të arsimit, gjinisë, institucioneve publik/privat, fushave të studimit (arsim i lartë), staf mësimdhënës, qarqeve, etj; Tregues statistikorë mbi diplomimet që llogariten me bazë vjetore, sipas niveleve të arsimit, gjinisë, institucioneve publik/privat, qarqeve, fushave të studimit (arsim i lartë), etj; Tregues mbi Shpenzimet gjithsej të buxhetit të shtetit për arsimin dhe % ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP); Tregues statistikorë kryesorë të përlllogaritur bazuar në anketën e Arsimit të të Rriturve, pjesëmarrja e popullsisë 25-64 vjeç në arsim dhe trajnim, sipas gjinisë, grupmoshave dhe nivelit arsimor të arritur.

Tema 1.4 “Shëndetësia”

Përbëhet nga nëntema 1.4.1 “Shëndeti publik”, sipas të cilës INSTAT ngarkohet të kryejë dy aktivitete statistikore me frekuencë vjetore: “Prodhimi i statistikave për shkaqet e vdekjeve” dhe “Prodhimi i statistikave për shëndetin publik”. Për statistikën e shkaqeve të vdekjeve do të shfrytëzohet burimi i të dhënave administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Ndërsa për statistikën e shëndetit publik do të shfrytëzohen burimet e të dhënave administrative që duhet të sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Shëndetit Publik dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Treguesit kryesorë: Tregues mbi shkaqet e vdekjes me frekuencë vjetore sipas grup sëmundjeve (ICD-9), gjinisë, grupmoshës dhe qarqeve; Tregues statistikorë mbi shërbimin e institucioneve me shtretër, konsultorin e gruas dhe fëmijës, aktiviteti i qëndrave shëndetësore; abortet sipas grupmoshave të nënës, nivelit arsimor të nënës e tj; aftësisë së kufizuar.

Tema 1.5 “Të ardhurat dhe shpenzimet e konsumit”

Për të prodhuar statistikën e kësaj kategorie, nga INSTAT do të përdoren burimet e mbledhura nëpërmjet kryerjes së dy aktiviteteve statistikore me frekuencë vjetore: “Anketa e Buxhetit të Familjes” dhe “Anketa e të Ardhurave të Nivelit të Jetesës”. Të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtyre dy aktiviteteve do të sigurojnë të dhëna për buxhetin e familjes, statistikën e të ardhurave, përfshirjes sociale dhe nivelit të jetesës. Si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe për të shmangur sa më shumë kontaktet e anketuesve me përfaqësuesit e njësive statistikore, për prodhimin e

treguesve nga vrojtimit “Anketa për Matjen e Nivelit të Jetesës” dhe “Anketa e Buxhetit në Familje”, përveç metodës tradicionale, INSTAT do të përdorë edhe alternativën të tjetër të mbledhjes së të dhënave nëpërmjet telefonit (metoda CATI).

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi përshkrimin e nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) në Shqipëri si dhe të treguesve të tjerë me bazë shpenzimet e konsumit; Tregues mbi Varfërinë dhe përjashtimin social, shpërndarjen e të ardhurave, pabarazinë dhe kushtet e banimit dhe privimin material.

Tema 1.6 “Mbrojtja sociale”

Treguesit e mbrojtjes sociale përfaqësohen me të dhëna administrative që kanë të bëjnë me ndihmën ekonomike, pagesën e papunësisë dhe pensionet në skemën e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu, INSTAT ka filluar punën përgatitore për implementimin e ESSPROS, fokusuar kryesisht në modulën e përfitimeve nga pensionet si dhe në klasifikimin e të skemave të përfitimeve. Ky aktivitet do të zhvillohet edhe gjatë vitit 2020 fokusuar në mbledhjen dhe klasifikimin e të dhënave bazë të Sistemit të Mbrojtjes Sociale.

Treguesit kryesorë: Variablat kryesore të të dhënave administrative mbi Mbrojtjen Sociale grupohen në këto kategori kryesore si: Të dhënat mbi masën e pagesës së papunësisë dhe numrit të përfituesve të kësaj pagese; Të dhënat mbi masën e ndihmës ekonomike dhe numrit të familjeve që e përfitojnë atë; Të dhënat mbi masën e pensionit urban dhe rural dhe numrit të personave që e përfitojnë atë.

Gjithashtu të dhëna më të plota lidhur me Mbrojtjen Sociale do të sigurohen nëpërmjet ESSPROS (Statistikat e Integruara Europiane të Mbrojtjes Sociale) i cili ka filluar të implementohet në Statistikat tona zyrtare.

Tema 1.7 “Drejtësia dhe Krimi”

Kjo temë përbëhet nga nëntema 1.7.1 “Statistikat e kriminalitetit dhe drejtësisë” e cila do të zbatohet nga INSTAT nëpërmjet përmbushjes së aktivitetit statistikor prodhues me frekuencë vjetore “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale”. Ky aktivitet përfshin statistika mbi vepra penale dhe autorë; procedime penale dhe të pandehur; të dhëna për të burgosurit dhe të dënuarit. Statistikat mbi veprat penale dhe autorë do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Statistikat mbi procedimet penale dhe të pandehur do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruar nga Prokuria e Përgjithshme. Statistikat mbi të burgosurit do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Statistikat mbi të dënuarit dhe çështjet penale do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative të siguruar nga Ministria e Drejtësisë.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi veprat penale të evidentuara nga policia bazuar në nenet e Kodit Penal; personat e dyshuar nga policia në kryerjen e një vepre penale; tregues mbi

procedime penale dhe të pandehur të regjistruar nga Prokuroria; tregues mbi të burgosurit sipas veprave specifike penale, grupmoshave dhe gjinisë; të dënuarit me burg dhe të paraburgosur sipas gjinisë, veprave penale dhe grupmoshës. Tregues mbi çështje penale dhe civile të përfunduara nga Gjykatat e Shkallës së Parë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë; të dënuarit nga Gjykatat e Shkallës së Parë, të ndara sipas gjinisë, dy ndarjeve të mëdha moshore, veprave penale.

Tema 1.8 “Kultura”

Statistikat e kulturës do të prodhohen nga INSTAT nëpërmjet përpunimit tremujor të të dhënave administrative të siguruar nga Ministria e Kulturës. Ky aktivitet përfshin statistika për institucionet e artit dhe kulturës, trashgimia kulturore dhe biblioteka kombëtare.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi numrin e shfaqjeve dhe spektatorëve në institucionet qendrore të kulturës; numri i vizitorëve vendas dhe të huaj në muze, kala dhe parqe arkeologjike; si edhe tregues nga biblioteka kombëtare.

Tema 1.9 “Përdorimi i kohës”

Nuk parashikohen aktivitete për vitin 2020.

Fusha 2 “Statistikat ekonomike” përbëhet nga 3 tema.

Tema 2.1 “Makroekonomike”

Në këtë temë përfshihen statistikat e llogarive kombëtare, të tilla si Prodhimi i Brendshëm Bruto, statistikat e qeverisë, deficitit, borxhi publik etj. Vlerësimi i këtyre treguesve realizohet duke përdorur të dhëna me burim administrativ dhe të dhëna nga vrojtimit statistikore. Struktura e temës përbëhet nga këto nëntema:

2.1.1 “Llogaritë sektoriale vjetore”, të cilat shprehin Llogaritë Jo-financiare Vjetore sipas sektorëve institucionalë, statistikat e të cilave prodhohen nga INSTAT me frekuencë vjetore, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankën e Shqipërisë;

2.1.2 “Llogaritë Kombëtare Tremujore dhe Vjetore, agregatët kryesorë”, e cila ndahet në dy aktivitete kryesore, duke u bazuar në frekuencën e treguesit.

Llogaritë Kombëtare Vjetore, të cilat si produkt kryesor kanë treguesin “Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)”, me metodën e Prodhimit dhe të Shpenzimeve, me çmime korrente dhe me çmimet e vitit paraardhës.

Aktivitet tjetër i kësaj nënteme është “Llogaritë Kombëtare tremujore”, duke prodhuar treguesin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), me metodën e prodhimit dhe atë të shpenzimeve, me çmime korrente dhe çmimet e vitit paraardhës, të përshtatura ose jo sezonalisht.

Këto statistika prodhohen nga kombinimi i burimeve të ndryshme të informacionit, të cilat sigurohen nga INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes

Financiare, Koorporata Energjitike Shqiptare, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në varësi të frekuencës së treguesit.

2.1.3 “Tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output”, të cilat ofrojnë një pasqyrë të detajuar të strukturës prodhuese të ekonomisë. Këto tabela prodhohen me frekuencë vjetore nëpërmjet përpunimit të të dhënave administrative apo të dhënave të mbledhura nga vrojtimitet statistikore. Institucionet e ngarkuara për dhënie të informacionit administrativ janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Enti Rregullator i Energjetikës, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Koorporata Energjitike Shqiptare (KESH);

2.1.4 “Llogaritë Rajonale” japin informacion mbi shpërndarjen gjeografike të Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe aktiviteteve ekonomike në Shqipëri. Këto statistika janë gjithashtu me frekuencë vjetore dhe prodhohen nëpërmjet kombinimit të të dhënave administrative nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), Koorporata Energjitike Shqiptare (KESH), etj., dhe të dhënave të siguruara nga vrojtimitet statistikore që zhvillon INSTAT.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi Llogarinë e prodhimit, gjenerimit të të ardhurave, të shpërndarjes së të ardhurave parësore dhe dytësore, të përdorimit të të ardhurave të disponueshme dhe atë kapitale; Tregues statistikorë mbi PBB Vjetore me metodën e prodhimit me çmime korente dhe konstante; Tregues statistikorë mbi PBB Vjetore me metodën e shpenzimeve me çmime korente dhe konstante; Tregues statistikorë mbi PBB tremujore, me metodën e prodhimit, me çmime korrente, me çmimet e vitit të mëparshëm dhe "chain link" sipas aktivitetit ekonomik, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht; Tregues statistikorë mbi PBB tremujore, me metodën e prodhimit, Vlerësimi “Flash”; Tabelat burime - përdorime me çmime korente, me çmime konstante; Tabela input - output me çmime bazë, për prodhimin e brendshëm me çmime bazë, për importet me çmime bazë, dhe mbi tabelat e përdorimeve çmime bazë e ndarë për prodhimin e brendshëm, importet dhe totale; Vlerësim i VSHB-së dhe PBB-së sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, dhe degëve kryesore të ekonomisë në seri kohore; Vlerësim i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3, si dhe të shprehura në termat e Paritetit të Fuqisë Blerëse si dhe sipas aktiviteteve ekonomike Nace Rev 2, niveli rajonal statistikor 2 dhe 3; Vlerësimi i Llogarive Rajonale të Familjeve sipas rajoneve statistikore, niveli 2 dhe 3.

Tema 2.2 “Statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe të sektorit publik”

Për prodhimin e statistikave të kësaj teme janë përgjegjës Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, sipas nëntemave si vijon:

2.2.1 “Llogaritë financiare – Metodologjia” dhe 2.2.2 “Llogaritë financiare – Prodhimi i të dhënave” - Banka e Shqipërisë kryen aktivitetin e prodhimit statistikor të llogarive financiare me

frekuencë vjetore, duke përpunuar burimet e siguruara nga INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

2.2.3 “Tregues Monetare dhe Financiarë”, në të cilën përfshihen prodhimi nga Banka e Shqipërisë i “Statistikave monetare dhe financiare”, “Statistikat e normave të interesit” dhe “Statistikat Monetare të institucioneve të tjera financiare”. Për statistikave monetare dhe financiare, të cilat kanë frekuencë mujore, Banka e Shqipërisë kryen aktivitetin statistikor mbi bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera depozituese; Agregatet monetare; Të dhëna të detajuara mbi depozitat dhe kredite, duke përdorur të dhënat e veta dhe ato të marra nga bankat e nivelit të dytë dhe shoqëritë Kursim –Krediti. Përsa i takon statistikave mbi normat e interesit, të cilat gjithashtu prodhohen në frekuencë mujore, Banka e Shqipërisë kryen aktivitet mbi statistikave të normave të interesit aplikuar për sasi të reja dhe sasi të gjendje, duke përdorur të dhënat e marra nga bankat e nivelit të dytë. Statistikat monetare dhe financiare prodhohen nga Banka e Shqipërisë gjithashtu në frekuencë tremujore, duke përllogaritur bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera financiare, si dhe duke përdorur të dhënat e marra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2.2.4 “Statistikat financiare të Qeverisë-Metodologjia” është nëntemë e cila mbulohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Kjo ministri, nën cilësinë e agjencisë statistikore, kryen aktivitetin e prodhimit statistikor mbi statistikave financiare të qeverisë sipas GFSM2014 dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen në frekuencë vjetore, nëpërmjet përpunimit të informacionit të marrë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme (institucione qendrore, vendore dhe fondet speciale).

2.2.5 “Statistikat mbi Defiçitin dhe Borxhin Publik” është nëntemë e cila gjithashtu mbulohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë duke prodhuar statistikave të borxhit të sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhit të garantuar, me frekuencë tremujore. Për prodhimin e këtyre statistikave, ministrisë i duhet të shfrytëzojë të dhënat që disponon, si dhe ato të marra nga Kreditorët dhe Banka e Shqipërisë.

Treguesit kryesorë: Përgatitja e Manualit metodologjik; Tregues statistikorë mbi Llogaritë financiare të sektorit të korporatave financiare, të jorzidentëve (pjesës tjetër të botës), të sektorit të qeverisë së përgjithshme, sektorit të korporatave jo-financiare, të ekonomive familjare dhe institucioneve jo me qëllim fitimi në shërbim të ekonomive familjare; Tregues statistikorë mbi Agregatet Monetare; Bilancin Sektorial dhe paraqitjen monetare të bankes qendrore, të bankave paradepozituese dhe të bankave të tjera depozituese; Paraqitjen monetare të korporatave depozituese; Depozitat e përfshira në paranë e gjerë; Kreditë për ekonominë; Tregues statistikorë mbi Normat e interesit për depozitat e reja, huatë e reja, depozitat gjendje në fund të periudhës, kreditë gjendje në fund të periudhës; Tregues statistikorë mbi Bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera financiare; Treguesi Statistikor Financiare të qeverisë sipas GFSM2014 dhe mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë; Informacion mbi borxhin e Qeverisë Qendrore buxhetore dhe borxhit të garantuar sipas instrumentave, maturimit dhe monedhës, tipit të interesit, koncensionalitetit si edhe borxhin e pushtetit lokal.

Tema 2.3 “Statistikat e biznesit”

Statistikat e biznesit prodhohen nga INSTAT, dhe ndahen në nëntemat si vijon:

2.3.1 “Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve”, për të cilën INSTAT kryen si aktivitete vrojtimit vjetor pranë ndërmarrjeve ekonomike, për prodhimin e statistikave strukturore në nivel kombëtar dhe rajonal për treguesit kryesorë; Si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19, realizimi në terren i vrojtimit vjetor “Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve” do të shtyhet me të paktën 30 ditë nga afati tradicional. Për të siguruar vazhdimësinë e statistikave të kësaj fushe, INSTAT do të shfrytëzojë edhe burimet administrative për llogaritjen dhe publikimin e të dhënave paraprake.

2.3.2 “Prodcom”, përmban statistika mbi produktet industriale të ndërmarrjeve, të cilat janë rezultat i të dhënave nga aktiviteti mbi vrojtimit vjetor që kryhet nga INSTAT për listën e produkteve industriale;

2.3.3 “Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve”, ku përfshihen tre aktivitete statistikore që performon INSTAT: i) vrojtimi tremujor për statistikafatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike, për prodhimin e statistikave tremujore të kësaj kategorie. Për tremujorin e parë të vitit 2020 INSTAT do të ndryshojë metodën e grumbullimit të të dhënave. Si pasojë e fatkeqësive natyrore, në muajt e parë të vitit 2020 të dhënat e mbledhura nga anketa në terren do të alternohen me të dhënat administrative dhe kontaktet e njësisve statistikore nëpërmjet metodës CATI (mundësia e kontaktit të ndërmarrjeve me Tel/Cel). Kjo metodë do të përdoret për herë të parë këtë vit nga INSTAT për këtë temë statistikore; ii) vrojtimi tremujor për statistikafatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike për prodhimin e statistikave tremujore të kësaj kategorie dhe iii) prodhimi i statistikave mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë me frekuencë tremujore, duke shfrytëzuar të dhënat administrative të marra nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe INSTAT.

2.3.4 “Regjistri i Ndërmarrjeve dhe Njësitë statistikore” përfshin aktivitetin me frekuencë vjetore mbi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave administrative dhe statistikore për përditësimin e regjistrave të njësisve ekonomike. Burimet kryesore janë Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe të dhënat e INSTAT. Gjithashtu, INSTAT kryen vrojtimit statistikor vjetor “Anketa e regjistrit të ndërmarrjeve”, pranë ndërmarrjeve ekonomike për të patur një regjistër biznesi më të përditësuar dhe statistika cilësore dhe koherente. Për vitin 2020 INSTAT parashikon përditësimin në kohë reale të regjistrit statistikor të ndërmarrjeve duke ndërtuar “*Live Register*”, duke shfrytëzuar gjithashtu informacionin e institucioneve të lartpërmendura

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi aktivitetet ekonomike, punësimin, të ardhurat e shpenzimet, investimet, dhe të dhëna specifike për ndërtimin, transportin rrugor, tregtinë dhe bar-kafetë e restorantet, etj; Tregues statistikorë kryesorë ekonomikë në nivel rajonal; Tregues statistikorë në volum dhe vlerë mbi produktet industriale; Tregues statistikorë mbi aktivitetin ekonomik, shitjet, prodhimin, numrin e personave të punësuar, fondin e pagave, treguesit specifikë të ndërtimit si dhe statistikafatshkurtra kryesore industriale; Tregues statistikorë mbi çmimet e prodhimit vendas, çmimet e prodhimit për eksport, çmimet e importit, çmimet e kushtimit në ndërtim dhe punime inxhinierike; Tregues statistikorë mbi numrin, sipërfaqen dhe vlerën e Lejeve të Ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë; Tregues lidhur

me regjistrin e ndërmarrjeve, si: numrin e ndërmarrjeve, pronësinë, formën ligjore, aktivitetin ekonomik, dhe tregues të tjerë për përditësimin dhe matjen e cilësisë së regjistrave statistikore të njësive ekonomike.

Fusha 3 “Statistikat sektoriale” përbëhet nga 8 tema.

Tema 3.1 “Statistikat e Bujqësisë, Peshkimit dhe Pyjeve”

Kjo temë përfshin nëntemën 3.1.1 “Statistikat e pyjeve dhe biodiversitetit”, për të cilin INSTAT mbledh dhe përpunon të dhëna administrative nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për prodhimin e statistikave të kësaj kategorie me frekuencë vjetore. Në lidhje me nëntemën 3.1.2 “Statistikat e Bujqësisë” kemi një tjetër ndarje sipas specifikave që mbulon:

3.1.2/a “Statistikat e produkteve bimore”. INSTAT është i ngarkuar të prodhojë statistikave të kësaj kategorie nëpërmjet kryerjes së aktivitetit “Vrojtimi Vjetor në Bujqësi 2019”, ku të dhënat parashikohet të mblidhen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me mbështetjen metodologjike të INSTAT, si dhe aktivitetit “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative”, ku INSTAT do të përpunojë të dhënat administrative të marra nga po kjo ministri. Gjithashtu, gjatë këtij viti do të kryhet dhe vrojtimi mbi sipërfaqen e mbjellë 2019.

3.1.2/b “Statistikat e blektorisë, mishit dhe vezëve”. Vrojtimi Vjetor në Bujqësi 2019 dhe përpunimi i të dhënave administrative, të parashikuar për statistikave të produkteve bimore, do të vlejné edhe për prodhimin e statistikave të blektorisë, mishit dhe vezëve. Sipas metodologjisë së parashikuar, mbledhja e të dhënave do të kryhet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ndërkohë që INSTAT do të kryejë përpunimit e tyre si institucion që gëzon statusin e prodhuesit të statistikave zyrtare. Përveç këtyre dy aktiviteteve, me qëllim nxjerrejen e statistikave të kësaj kategorie me frekuencë mujore, INSTAT do të kryejë edhe “Vrojtimin mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta”, “Vrojtimin mujor mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve të shpendëve” dhe “Vrojtimin mujor në pularitë për prodhimin e vezëve”.

3.1.2/c “Statistikat e qumështit dhe nënprodukteve të tij”. Për prodhimin e statistikave të kësaj kategorie, ashtu si dhe për kategoritë e tjera më lart, do të ketë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet INSTAT dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Kështu, INSTAT do të kryejë aktivitetin statistikor me frekuencë vjetore “Vrojtimi vjetor në fabrikat dhe baxhot që grumbullojnë dhe përpunojnë qumësht” dhe aktivitetin me frekuencë mujore “Vrojtimi mujor në fabrikat që grumbullojnë dhe përpunojnë qumështin e lopës”. Ndërkohë do të vazhdojë mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative nga ministria e lartpërmendur për prodhimin e statistikave vjetore të kësaj kategorie.

3.1.2/d “Llogaritë ekonomike në bujqësi” përfshin përpunimin në tërësi të të dhënave të mbledhura nëpërmjet aktiviteteve statistikore të lartpërmendura në fushën e bujqësisë dhe blektorisë, por edhe kryerjen e dy aktiviteteve të tjera nga INSTAT: “Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore” dhe “Anketa tremujore e çmimeve të inpueteve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështrim”.

Statistikat e peshkimit parashikohet të prodhohen nga INSTAT sipas nëntemës 3.1.3 “Statistikat e peshkimit”. Për këtë, INSTAT do të kryejë aktivitetet: “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

administrative nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” për prodhimin e statistikave mbi prodhimin e peshkut me frekuencë tremujore, “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative për peshkimin dhe akuakulturën” për prodhimin e statistikave me frekuencë vjetore. “Statistikat e prodhimeve organike në bujqësi”, që janë pjesë e nëntemës 3.1.4, janë mbledhur për vitin 2019 sipas legjislacionit Shqiptar. Gjithashtu, edhe për nëntemën 3.1.5 “Statistikat e agromjedisit” INSTAT do të kryejë përpunimin e të dhënave administrative të marra nga ministria për prodhimin e statistikave për qëllim të brendshëm.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi pyjet, kullotat, gjuetinë dhe ekosistemet; të dhënat kadastrale të fondit për pyjet, kullotat dhe kundërvajtjet në pyje, speciet e rrezikuara dhe ato të mbrojtura për florën dhe faunën, numrin dhe sipërfaqen e zonave të mbrojtura, strukturën dhe bilancet në pyje e kullota si dhe bilanci burim-përdorim i produkteve pyjore; Tregues statistikorë mbi sipërfaqen, prodhimin, rendimentin dhe përmbajtjen e lagështisë për drithërat dhe bishtajoret, në nivel kombëtar dhe rajonal; bimët e tjera të mbjella në tokë arë, në nivel rajonal; pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullirin, në nivel rajonal; Tregues statistikorë mbi numrin e krerëve, prodhimi i mishit, sipas kategorive, Struktura e blegtorisë dhe e shpendëve sipas llojeve dhe numri i kafshë të therura gjatë vitit në fermë sipas llojeve dhe kategoritë statistikore të therjeve, pesha e gjallë totale dhe pesha e therur totale sipas llojeve të kafshëve; Tregues statistikorë mbi numrin e krerëve, prodhimin e mishit dhe produkteve të tjera blegtorale; Tregues statistikorë mbi numrin kafshëve të therura gjatë vitit në thertore sipas llojeve dhe kategorive statistikore të therjeve, pesha e gjallë totale dhe pesha e therur totale; Tregues statistikorë mbi numrin e shpendëve të therur gjatë vitit në thertore sipas llojeve, peshën e gjallë dhe peshën e therur; Tregues statistikorë mbi prodhimin e shpendëve dhe vezëve për treg; Tregues statistikorë mbi qumështin dhe produktet e tij sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave, mbi strukturën e fabrikave dhe baxhove që grumbullojnë qumësht dhe e përpunojnë; Tregues statistikorë mbi sasinë e qumështit të lopës të grumbulluar si dhe sasinë e nënprodukteve kryesore të prodhuara; Tregues statistikorë mbi sasinë e qumështit të prodhuar në fermë sipas llojeve: lope, dele dhe dhie me periodicitet vjetor dhe në nivel prefekturë; sasinë e konsumit të qumështit të freskët në fermë, si dhe produktet e qumështit në fermë me periodicitet vjetor në nivel kombëtar dhe prefekturë; Tregues statistikorë mbi llogaritë ekonomike në bujqësi; Çmimet e tokës bujqësore, përfshirë qiranë; Inputet e punës në bujqësi; Indeksi i çmimeve të produkteve bujqësore; Indeksi i çmimeve të inputeve në bujqësi; Tregues statistikorë mbi prodhimin e peshkut, molusqeve, strukturën e ndërmarrjeve prodhuese si dhe numrin e të punësuarve; peshkimin detar sipas porteve; numrin e anijeve dhe zënien e peshkut sipas porteve; Tregues statistikorë për peshkimin në ujërat e brendshme dhe për numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në akuakulturë dhe molusqe; Tregues statistikorë mbi çmimet mesatare dhe sasinë e zënies së peshkut sipas kategorive ujore; Tregues statistikorë mbi operatorë organikë të regjistruar dhe çertifikuar, si: prodhues, përpunues, importues dhe të tjerë, gjatë vitit referues, si dhe të rinj gjatë vitit, të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e çertifikimit me periodicitet vjetor; sipërfaqet organike të çertifikuara dhe në proces konvertimi dhe prodhimet organike bimore me periodicitet vjetor; blegtorinë e çertifikuar, prodhimin e produkteve organike me origjinë blegtorale me periodicitet

vjetor; përpunimin e produkteve organike sipas aktivitetit ekonomik; Tregues statistikor mbi: sasinë e plehrave kimike të përdorura sipas grup kulturave periodicitet vjetor; sipërfaqet e plehëruara me plehra kimike periodicitet vjetor; sasinë e pesticideve të përdorura sipas grup kulturave me periodicitet vjetor; sipërfaqet e trajtuara me pesticide sipas llojit të pesticideve dhe grup kulturave me periodicitet vjetor; Tregues statistikorë mbi: mbulimin dhe përdorimin e tokës me periodicitet vjetor; tokën e punueshme, livadhet dhe kullotat, tokën e zënë me pemtore (pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta) dhe tokë tjetër jobujqësore me periodicitet vjetor.

Tema 3.2 “Energjia”

Kjo temë përmban vetëm një nëntemë 3.2.1 “Statistikat e Energjisë – prodhimi”. INSTAT do të kryejë prodhimin e statistikave të Bilancit të Energjisë Elektrike me frekuencë tremujore, duke përpunuar të dhënat administrative të marra nga Koorporata Energjitike Shqiptare, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe të dhënat që disponon INSTAT. Gjithashtu, INSTAT do të prodhojë statistikën e Bilancit të Përgjithshëm të Energjisë me frekuencë vjetore, duke përpunuar të dhënat administrative të siguruara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, importin dhe eksportin bruto të energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë; Tregues statistikorë mbi bilancin energjitik i cili paraqet situatën aktuale në sektorin e energjisë në vend për origjinën dhe përdorimin specifik sipas burimeve të energjisë.

Tema 3.3 “Transporti”

Tema e statistikave të transportit përfshin dy nëntema: 3.3.1 “Statistikat e Transportit” dhe 3.3.2 “Statistikat mbi sigurinë në rrugë”. Statistikat e nëntemës së parë kanë frekuencë mujore dhe vjetore që prodhohen nga INSTAT duke kryer aktivitetin “Prodhimi i treguesve statistikorë mbi transportin ajror, detar, ujqor i brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve” dhe “Prodhimi i treguesve mbi inventarin e mjeteve të transportit rrugor”. Për realizimin dhe publikimin e këtyre statistikave, INSTAT përpunon të dhënat administrative të marra nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës. Përsa i takon nëntemës tjetër, INSTAT kryen aktivitetin statistikor me frekuencë mujore “Prodhimi i treguesve statistikorë mbi Aksidentet”. Për realizimin e këtyre statistikave, INSTAT përpunon të dhënat administrative të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Si pasojë e situatës së Covid-19, duke qenë se do të ketë vonesa në përpunimin e të dhënave administrative për qëllimet e INSTAT nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, mbledhja e të dhënave administrative nuk do të kryhet sipas parashikimit në PSZ. Megjithatë, INSTAT do të publikojë statistikën e transportit rrugor brenda këtij viti.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi transportin ajror, detar, ujqor i brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve, në nivel kombëtar dhe sipas rajoneve; Tregues statistikorë mbi inventarin e mjeteve të transportit rrugor; Tregues statistikorë mbi transportin

rrugor të mallrave në vlerë dhe volum; Tregues statistikorë mbi numrin e aksidenteve rrugore, numrin e të aksidentuarve (të vdekur dhe të plagosur) dhe numrin e aksidenteve hekurudhore, në nivel kombëtar dhe sipas rajoneve.

Tema 3.4 “Turizmi”

Statistikat e kësaj kategorie përfshijnë dy nëntema:

3.4.1 “Statistikat e Turizmit”, ku përfshihet aktiviteti me frekuencë mujore “Prodhimi i treguesve statistikorë mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë” i cili do të kryhet nga INSTAT nëpërmjet përpunimit të të dhënave të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Me qëllim që të llogarisë treguesit statistikorë mbi ofertën akomoduese të turizmit shqiptar, INSTAT kryen vrojtimin statistikor mujor “Anketa e Strukturave Akomoduese” pranë hoteleve dhe strukturave të ngjashme. Për shkak të Covid-19, do të ketë vonesë në mbledhjen e të dhënave në këto njësi statistikore. Për rrjedhojë, INSTAT do të përdorë alternativën e përdorimit të metodës CATI për të kuptuar ecurinë e aktiviteteve të tyre.

3.4.2 “Statistikat e Turizmit në Njësitë Ekonomike Familjare (NjEF)” statistikat vjetore të së cilës do të prodhohen nëpërmjet aktivitetit të INSTAT “Anketa e Turizmit në Familje "Pushime dhe Udhëtime”. Publikimi i rezultateve të Anketës së Turizmit në Familje 2020, ku si vit referencë i mbledhjes së të dhënave është viti 2019, do të vijojë sipas parashikimit. Si rezultat i fatkeqësive natyrore, është e pamundur të kryhet puna në terren për mbledhjen e të dhënave për vitin referencë 2020. Për të siguruar mbarëvajtjen e aktivitetit dhe, për rrjedhojë, edhe validimin e të dhënave, INSTAT do të zbatojë rekomandimet e Eurostat.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë, sipas mënyrës së transportit, sipas shteteve, sipas mënyrës së qëllimit të vizitës; Tregues statistikorë mbi turizmin në Shqipëri; Tregues statistikorë mbi kapacitetin e njësive akomoduese, numrin e turistëve, netëqëndrimet, numrin e turistëve sipas shteteve, kapacitetin shfrytëzues; Tregues statistikorë mbi përshkrimin e nivelit dhe strukturës së Turizmit në familje, ana e kërkesës (*demand side*) për periudha tremujore dhe vjetore, në përputhje me kërkesat e rregullores të KE Nr. 692/2011 (Aneksi II) dhe kërkesave të përdoruesve të brendshëm.

Tema 3.5 “Tregtia e Jashtme”

Kjo temë është e ndarë në disa nëntema:

3.5.1 “Statistikat mbi FATS” janë statistika të ndërmarrjeve me kapital të huaj në vend dhe të ndërmarrjeve shqiptare jashtë vendit (IFATS). Nëntema e statistikave FATS do të përmbushet pjesërisht nëpërmjet kryerjes nga INSTAT të aktivitetit me botimin “Bizneset e Huaja në Shqipëri” i cili ka frekuencë vjetore, duke shfrytëzuar të dhënat e INSTAT dhe ato të siguruara nga Banka e Shqipërisë.

3.5.2 “Investimet e huaja direkte”, statistikat e të cilës prodhohen nga Banka e Shqipërisë me frekuencë tremujore, duke shfrytëzuar të dhënat e marra nga Banka e Shqipërisë, Agjencia

Kombëtare e Burimeve Natyrore, Qendra Kombëtare e Biznesit si dhe të dhëna të tjera të prodhuara nga vrojtime statistikore pranë kompanive private.

3.5.3 “Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve” do të mbulohet gjithashtu nga Banka e Shqipërisë. Statistikat janë të frekuencës vjetore dhe do të prodhohen nga përpunimi i të dhënave të siguruar nga Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe të dhëna të tjera nga vrojtime statistikore pranë kompanive private dhe individëve.

3.5.4 “Statistikat e tregtisë së jashtme”. Në këtë nëntemë përfshihen statistikat e tregtisë së jashtme (eksporte/importe) të mallrave të cilat do të prodhohen nga INSTAT me frekuencë mujore nëpërmjet përpunimit të të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe nëpërmjet prodhimit të treguesve statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve në frekuencë vjetore..

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë për kompanitë rezidente me pjesëmarrje të kapitalit të huaj (IFATS); Tregues statistikorë për kompanitë rezidente me pjesëmarrje të kapitalit të huaj (botimi "Bizneset e Huaja në Shqipëri"); Tregues statistikorë mbi kompanitë shqiptare jashtë vendit; Tregues statistikorë mbi: fluksin e investimeve direkte sipas shteteve, aktivitetit ekonomik, shteteve dhe aktivitetit ekonomik; stokun i investimeve direkte sipas shteteve dhe aktivitetit ekonomik; Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve sipas shteteve; Tregues statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave; Tregues statistikorë mbi eksportet/importet e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

Tema 3.6 “Bilanci i Pagesave”

Për prodhimin e statistikave të kësaj teme është ngarkuar me ligj Banka e Shqipërisë. “Statistikat e bilancit të pagesave” do të kenë frekuencë mujore dhe tremujore si dhe statistikat mbi “Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare” me frekuencë tremujore, të cilat do të prodhohen nëpërmjet përpunimit të të dhënave të siguruar nga Banka e Shqipërisë, INSTAT, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe të dhëna të tjera nga vrojtime statistikore pranë kompanive private dhe individëve.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë mbi bilancin tremujor të pagesave; Tregues statistikorë mbi bilancin mujor të pagesave; Tregues tremujor mbi pozicionin e investimeve ndërkombëtare.

Tema 3.7 “Çmimet”

Statistika e çmimeve është e ndarë në disa nëntema si më poshtë:

3.7.1 “Statistikat e Çmimeve të Konsumit” e matur nëpërmjet dy treguesve kryesor: “Indeksi i Çmimeve të Konsumit” dhe “Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)”. Këto indekse prodhohen çdo muaj nga INSTAT nëpërmjet kryerjes së vërtetimit mujor të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh pranë njësisive të tregtisë me pakicë si dhe duke

shfrytëzuar të dhënat të tjera të marra nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Bashkitë, Enti Rregullator i Ujit/Ujësjellës Kanalizime Tiranë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Univesitetet. 3.7.2 “Indeksi i Nivelit të Çmimeve dhe , Prodhimii Brendshëm Bruto për frymë në Standartin e Fuqisë Blerëse” është nëntemë e veçantë dhe parashikon kryerjen e aktivitetit statistikor “Pariteti i Fuqisë Blerëse (PFB)”. Statistikat e kësaj kategorie do të prodhohen nga Eurostat me frekuencë vjetore duke përdorur të dhënat e vrojtimit të ndryshme të çmimeve të konsumit, ndërtimit, makineri e pasije, qirave, spitaleve dhe të dhënave të tjera shtesë të realizuara nga INSTAT për llogaritjen e këtyre treguesve.

3.7.3 “Indeksi i Çmimeve të Banesave” është aktivitet statistikor në formë studimi ku INSTAT parashikon të prodhohë statistika me frekuencë tremujore duke shfrytëzuar të dhënat administrative të marra nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ose vrojtimit statistikor.

Treguesit kryesorë: Indeksi mujor, Ndryshimi vjetor, Ndryshimi mujor, Indeksi mesatar vjetor; Ndryshimi mesatar vjetor, Indeksi Çmimeve të Konsumit, Indeksi i Harmonizuar i Çmimevetë Konsumit, Indeksi i nivelit të çmimeve, PBB për frymë në Standardin e Fuqisë Blerëse.

Tema 3.8 “Shkenca, Teknologjia dhe Inovacioni”

Në këtë temë përfshihen këto nëntema:

3.8.1 “Statistikat e shkencës dhe teknologjisë”, 3.8.2 “Statistikat e Inovacionit”, 3.8.3 “Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, 3.8.4 “Koordinimi për Konfidencialitetin Statistikor dhe Aksesin në Mikrodata”, 3.8.5 “Standardizimi statistikor i të dhënave dhe metadatave”; 3.8.6 “Aplikimi i Generic Statistical Business Process Model (GSBPM)”; 3.8.7 “Cilësia Statistikore” dhe 3.8.8 “Mbrojtja e të Dhënave”.

Siç vihet re, përveç kategorive statistikore në këtë temë përfshihen edhe aktivitete që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor dhe cilësisë së prodhimit, si dhe garantimin e zbatimit të standardeve statistikore në lidhje me respektimin e konfidencialitetit.

Për nëntemat e mësipërme parashikohen aktivitetet si vijon:

3.8.1 “Statistikat e shkencës dhe teknologjisë”. Për statistikat e kësaj kategorie INSTAT do të kryejë Vrojtimin vjetor mbi aktivitetin e Kërkimit Shencor dhe Zhvillimit për sektorët e institucioneve publike dhe të arsimit të lartë.

3.8.2 "Statistikat e inovacionit", INSTAT do të kryejë Vrojtimin vjetor të Inovacionit pranë ndërmarrjeve.

3.8.3 “Statistikat e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”. Për prodhimin e statistikave të kësaj nënteme, INSTAT do të kryejë dy vrojtimit:

a) Vrojtimin vjetor mbi “Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit” në ndërmarrje, për të cilin mbledhja e të dhënave do të kryhet në muajin Maj duke ndryshuar metodën e

grumbullimit nëpërmjet intervistimit të kontakteve të njërive statistikore me telefon si pasojë e Covid-19. Gjithashtu, INSTAT do të realizojë prodhimin dhe publikimin e regjestrave mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit nga ndërmarrjet për vitin referencë 2019.

Anketën mbi “Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit” në Njësitë Ekonomike Familjare (NjEF). Statistikat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit do të kenë frekuencë vjetore. Publikimi i rezultateve të TIK në familje për vitin 2020 do të shtyhet si rezultat i ndërprerjes së procesit të mbledhjes së të dhënave në terren, si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19.

3.8.4 “Koordinimi për Konfidencialitetin Statistikor dhe Aksesin në Mikrodata”.

Në lidhje me këtë nëntemë, INSTAT synon të ndërtojë Sistemin e Informacionit për aksesin në Mikrodata nëpërmjet Internetit. Ky sistem ka si qëllim kryesor rritjen e përdorimit të bazave të të dhënave nga kërkuesit shkencorë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke siguruar konfidencialitetin statistikor. Gjatë vitit 2020, INSTAT do të pilotojë sistemin me anë të një projekti kërkimi me synimin testimin e të gjitha fazave të procesit të punës.

3.8.5 “Standardizimi statistikor i të dhënave dhe metadatave”.

Nën cilësinë e institucionit përgjegjës për drejtimin e Sistemit Kombëtar Statistikor, gjatë vitit 2020 INSTAT do të kryejë një sërë aktiviteteve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e standardeve të prodhimit dhe cilësisë. Për këtë qëllim, INSTAT do të vazhdojë të përdorë standardet e përcaktuara për metadatat strukturore dhe referenciale që disponon në institucionin si dhe do të transferojë në Eurostat metadatën në përputhje me standardin evropian për të gjitha fushat e prodhimit statistikor. Gjithashtu, publikimi në faqen e web-it të INSTAT i raporteve të metadatatave sipas fushave të prodhimit statistikor do të ndikojë në transparencën e prodhimit statistikor dhe forcimin e marrëdhënies me përdoruesit. Rritja e kapaciteteve në lidhje me prodhimin e metadatave dhe raporteve të cilësisë për agjencitë e tjera statistikore është një tjetër synim i INSTAT brenda kësaj nënteme për vitin 2020.

3.8.6 “Aplikimi i *Generic Statistical Business Process Model (GSBPM)*”.

Statistikat e prodhuara duke ndjekur standardin GSBPM ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e tyre pasi sistemi ndihmon në planifikimin dhe monitorimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave në çdo hap të tij. Standardi GSBPM po aplikohet në pjesën më të madhe të sistemeve statistikore ndërkombëtare. INSTAT e ka filluar aplikimin e këtij standardi prej vitit 2017, megjithatë, duke qenë se konsiderohet si instrument i rëndësishëm që ndikon në cilësinë statistikore jo vetëm të INSTAT por edhe agjencive të tjera, për vitin 2020 institucioni parashikon trajnimin për familjarizimin dhe njohjen e GSBPM nga të gjitha institucionet e Sistemit Kombëtar Statistikor. INSTAT-i gjatë vitit 2020, planifikon të harmonizojë proceset statistikore në drejtim të GSBPM, në bashkëpunim me Zyra të tjera Statistike Evropiane, aty ku është e mundur.

3.8.7 “Cilësia Statistikore”.

Në vijim të përmirësimit të cilësisë së produkteve statistikore zyrtare, INSTAT do të kryejë një sërë aktivitete të cilat janë pjesë e kësaj nënteme dhe e Planit Vjetor 2020. Në drejtim të cilësisë, INSTAT për vitin 2020 do të harmonizojë definicionet statistikore me ato që përdor Eurostat, do të përfshijë disa pyetjeve dedikuar matjes së treguesve të cilësisë në pyetësorët anketave të INSTAT si dhe do të zbatojë dhe standardizojë raportimin e cilësisë në INSTAT.

Në vijim të përmirësimit të cilësisë statistikore, INSTAT do të kryejë vlerësime periodike nëpërmjet matjes së kënaqësisë së përdoruesve apo kënaqësisë së punonjësve të INSTAT dhe do të përgatisë pyetësorin e vetëvlerësimit për 2 aktivitete statistikore. Duke qenë i ngarkuar me ligj të mbulojë edhe procese të auditimit statistikor, për vitin 2020 INSTAT parashikon të kryejë auditime për 1 aktivitet statistikor.

3.8.8 “Mbrojtja e të Dhënave” është një nëntemë tjetër e rëndësishme brenda temës mbi teknologjinë e prodhimit statistikor. Në këtë drejtim, për vitin 2020 INSTAT parashikon të kryejë aktivitete mbi përmirësimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të teknologjisë në nivel hardware dhe software në mbledhjen e të dhënave, duke ruajtur ndërkohë konfidencialitetin dhe privatësinë si dhe mbi përmirësimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave dhe dokumentimin e plotë të procedurave.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë lidhur me përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në ndërmarrje ekonomike me 10 e më shumë të punësuar; Tregues statistikorë mbi nivelin e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga familjet (NjEF) dhe individët në nivel kombëtar dhe me periodicitet vjetor.

Fusha 4 “Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain” përbëhet nga dy tema si vijon:

Tema 4.1 “Mjedisit”

Statistikat e mjedisit parashikohet të prodhohen në vitin 2019 sipas këtyre nëntemave:

4.1.1 “Llogaritë Monetare Mjedisore”. Sipas kësaj nënteme, INSTAT do të prodhojë statistika mbi taksat mjedisore, me frekuencë vjetore, duke shfrytëzuar të dhënat e veta si dhe të dhënat administrative të siguruar nga Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

4.1.2 “Llogaritë Fizike Mjedisore”, sipas të cilës INSTAT do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat administrative të siguruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe agjencitë e tyre për prodhimin e statistikave mbi llogaritë rrjedhëse fizike në mjedis.

4.1.3 “Statistikat mbi menaxhimin të mbetjeve dhe substancave të rrezikshme”, ku INSTAT do të kryejë prodhimin vjetor të statistikave mbi mbetjet, bazuar në të dhënat administrative të siguruar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Gjithashtu, brenda kësaj nënteme INSTAT do të kryejë prodhimin vjetor të statistikave mbi mbetjet, bazuar në vrojtimin mbi mbetjet e ngurta urbane të kryera nga vetë institucioni.

4.1.4 “Statistikat e ujit”. Prodhimi vjetor i statistikave të ujit nga INSTAT do të bazohet në të dhënat administrative të siguruara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

4.1.5 “Statistikat mbi cilësinë e ajrit dhe zhurmat”. Këto statistika do të prodhohen gjithashtu nga INSTAT me frekuencë vjetore, duke mbledhur e përpunuar të dhënat administrative të siguruara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe agjencive të tyre në varësi.

Treguesit kryesorë: Tregues statistikorë vjetorë mbi taksat në mjedis në total vendi; Tregues statistikorë vjetorë mbi shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit dhe të ardhurat në total vendi; Tregues statistikorë vjetorë mbi të mirat dhe shërbimet në mjedis në total vendi; Tregues statistikorë vjetorë mbi llogaritë rrjedhëse fizike në mjedis në total vendi; Tregues statistikorë vjetorë mbi llogaritë rrjedhëse fizike të energjisë në total vendi; Tregues statistikorë vjetorë mbi llogaritë e emetimeve në ajër në total vendi; Tregues statistikorë mbi menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme në nivel vendi; Tregues statistikorë mbi mbetjet e ngurta urbane, mbetjet e ngurta industriale; Tregues statistikorë mbi ujin, cilësinë e ajrit dhe zhurmat në nivel vendi dhe në qytete kryesore.

Tema 4.2 “Informacioni statistikor rajonal dhe gjeohapësinor”

Është e ndarë në tre nëntema: 4.2.1 “Informacioni rajonal”, 4.2.2 “Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore” dhe 4.2.3 “Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor (NSDI Kombëtare)”.

Për nëntemën e parë, 4.2.1, kërkesa për informacion statistikor në nivel rajonal dhe veçanërisht në nivel lokal është rritur me shpejtësi me Reformën e re Territoriale dhe Administrative të Qeverisjes Vendore në Shqipëri. Sistemi statistikor shqiptar synon të mbështesë autoritetet lokale dhe kombëtare në nevojën e tyre për statistika të detajuara rajonale dhe lokale.

INSTAT ka diskutuar me partnerët përkatës vendorë dhe ata qendrorë një listë të të dhënave dhe indikatorëve kyç statistikorë të nevojshëm për t'u përshtatur me strukturën e re territoriale dhe administrative (Njësitë Administrative Vendore/Bashkitë) të Shqipërisë. Si rezultat, janë identifikuar fushat e mëposhtme:

- Popullsia dhe dinamika e popullsisë
- Punësimi / Papunësia (përbërja e fuqisë punëtore)
- Ndihma sociale
- Përbërja e Njësisë Ekonomike Familjare dhe buxheti familjar
- Mjedisi / Mbetjet
- Shërbimet shëndetësore
- Mbulimi i tokës dhe përdorimi i tokës

- Statistikat e ndërmarrjeve

Gjatë vitit 2020 INSTAT do të fokusohet identifikimin e mundësive për ndërveprimin e të dhënave dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale e infrastrukurore në këto fusha.

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore, sipas nëntemës 4.2.2,

Gjatë vitit 2020, INSTAT do të vazhdojë me aktivitetet e përditësimit të zonave të censit.

Pas përditësimit të zonave të cens në terren, është i nevojshëm kryerja në zyrë i përditësimit të të dhënave gjeohapësinore të mbledhura në terren, sa i përket kontrolleve cilësore të ndërtesave, hyrjeve dhe informacioneve të tjera gjeohapësinore; përditësimi i kufirit të EA sipas ndryshimit të numrit të përgjithshëm të ndërtesave / banesave; përditësimi i kufirit të EA me kufirin e bashkisë; rikodifikimi i ndërtesave, hyrjeve dhe Ea-ve. INSTAT do të sigurojë mbulimin e plotë të gjeografisë së Cens për të gjithë territorin e vendit.

Sigurimi i hartës do të lehtësojë orientimin, navigimin dhe mbulimin gjatë fazës së Cens.

Në lidhje me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapsinor (NSDI Kombëtare), nëntema 4.2.3, INSTAT do të fokusohet në transformimin dhe harmonizimin e të dhënave gjeografike për dy temat në kuadrin e NSDI shqiptare, sipas specifikimeve të Direktivës së INSPIRE-it. Për këtë qëllim, INSTAT në bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor parashikon të kryejë dy aktivitete me frekuencë 5-vjeçare: Transformimi dhe harmonizimi i standardeve për temën "Demografia" dhe "Transformimi dhe harmonizimi i standardeve për temën "Njësitë Statistikore".

Produktet kryesore: Baza e të dhënave gjeohapsinore për qëllime statistikore e përditësuar dhe e mirëmbajtur për të mbështetur aktivitet statistikore (cense, vrojtime, anketa, etj); Inventarizimi i numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre;

Mbulimi i plotë i gjeografisë së Cens për të gjithë territorin e Shqipërisë.

Transformimi i të dhënave hapësinore për dy temat "Njësitë statistikore" dhe "Demografia" të harmonizuara dhe publikuara në shërbimet e Gjeoportalit Kombëtar dhe Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor, sipas Direktivës INSPIRE, duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor.

3.2 Censi i Popullsisë dhe Banesave

Censi i fundit i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri është kryer me sukses në tetor 2011. që atëherë, kushtet sociale, politike, dhe ekonomike në vend kanë ndryshuar. Censi i Popullsisë dhe Banesave do të luajë një rol vendimtar në përditësimin e informacionit statistikor të nevojshëm në nivel lokal dhe rajonal dhe në kuptimin dhe paraqitjen e ndryshimeve që kanë ndodhur në Shqipëri që nga viti 2001 dhe 2011. Ky informacion është thelbësor për krijimin e politikave të mbështetuara në statistika dhe përcaktimin e qëllimeve dhe planeve socio-ekonomike për zhvillimin e qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe për një sistem statistikor të qëndrueshëm dhe efikas, bazuar në një kombinim e përdorimit të të dhënave administrative dhe vrojtimeve.

Censi i Popullsisë dhe Banesave do të ndjekë "Rekomandimet për Censin e Popullsisë

dhe Banesave 2020 të Konferencës së Statistikanëve Evropianë”, të cilat janë hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Eurostat dhe në përputhje me rishikimin e "Parimeve dhe Rekomandimeve për Censet e Popullsisë dhe Banesave" globale: raundi i vitit 2020”.

3.2.1 Objektivat strategjike të Censi-t të Popullsisë dhe Banesave

- Censi do të krijojë informacionin bazë statistikor mbi popullsinë, ndërtesat dhe banesat për të gjithë territorin e Shqipërisë, i cili është thelbësor për ndërtimin e institucioneve, zhvillimin e qëndrueshëm, demokracinë dhe qeverisjen e mirë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.
- Të dhënat e Censit do të bëhen të krahasueshme me ato të vitit 2011 dhe 2001 dhe do të nxjerrin në pah ndryshimet demografike, ekonomike dhe shoqërore gjatë dy dekadave për njësitë e vjetra dhe të reja territoriale dhe administrative. Të dhënat do të shërbejnë gjithashtu për krahasimet ndërkombëtare duke ndjekur kërkesat e rregulloreve të BE.
- Të dhënat do të bëhen të disponueshme në formë të agreguar dhe si të dhëna mikro duke filluar nga zonat më të vogla gjeografike në nivel bashkiak dhe kombëtar përmes një rrjeti 1km² për të lehtësuar zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve të zhvillimit, si dhe për qëllime të tjera politike dhe kërkime shkencore. Kujdes më i madh do të ushtrohet për të mbrojtur konfidencialitetin dhe për të parandaluar zbulimin pa dashje të informacionit të Censit rreth individëve apo njërive të tjera statistikore të identifikueshme.
- INSTAT do të përdorë teknologji moderne për të përgatitur dhe kryer Censin në terren në një mënyrë të besueshme, efikase dhe kosto efektive. Investimet në harduer, softuer dhe ngritja e kapaciteteve do të forcojnë mjedisin e përgjithshëm të TI-së të INSTAT-it dhe të japin zgjidhje të qëndrueshme dhe të ripërdorshme për vrojtime apo aktivitete të tjera statistikore.
- Censi do të përdorë burimet administrative të disponueshme për fazën përgatitore si dhe për kontrollin e cilësisë. INSTAT-i gjithashtu do të punojë me institucione të tjera publike për të krijuar kushtet e nevojshme për krijimin e një regjistri statistikor ndërtesash dhe banesash dhe një regjistri statistikor të popullsisë rezidente që do të shërbejnë si burim për zhvillimin e censeve mbështetur në regjistra pas këtij raundi. Bazuar në Cens, INSTAT gjithashtu do të ndërtojë një bazë të re zgjedhjeje për vrojtimet statistikore, e cila do të përmirësojë infrastrukturën bazë të të gjithë sistemit statistikor.
- Lidhur me informimin e popullsisë, rekrutimin dhe informimin e anketuesve, kontrollorëve dhe mbikëqyrësve dhe përgatitjen e bashkive dhe administratës për Censin, INSTAT do të iniciojë konsultime dhe do të zhvillojë një fushatë të gjerë komunikimi për pjesëmarrjen e qytetarëve, metodologjinë, përmbajtjen dhe të dhënat e pritshme të Censit.
- Në përcaktimin e temave, koncepteve dhe përkufizimeve, programeve statistikore dhe metadatave të të dhënave të Censit, INSTAT do të ndjekë rekomandimet e Kombeve të Bashkuara, rregulloren kornizë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe rregulloret e zbatimit të Komisionit Evropian.

3.2.2 Aktivitetet kryesore të Censeve për vitin 2020

A. Censi i Popullsisë dhe Banesave

Gjatë vitit 2020 do të vazhdojë puna përgatitore për realizimin e Censit. Në aspektin e përcaktimit të kuadrit ligjor për kryerjen e censit, brenda këtij viti INSTAT pret miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të projektligjit i të ri “Për censin e popullsisë dhe banesave”. Projektakti do të mundësojë përafrimin e standardeve të reja të Kombeve të Bashkuara për censet e radhës si dhe do të shërbejë si akti bazë për nxjerrjen e akteve të tjera të karakterit operacional, duke patur parasysh ndarjen e re administrative të Republikës së Shqipërisë, statusin e INSTAT si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e censit dhe rolin e organeve të vetëqeverisjes vendore.

Faza përgatitore përfshin kryerjen e teste të ndryshme. Testi më i madh dhe gjithëpërfshirës është piloti i Censit, i realizuar gjatë vitit 2019. Gjatë 2020 do të analizohen gjetjet e pilotit për përmirësimin e mëtejshëm të të gjitha fazave të Censit. Do të analizohet efektiviteti i strukturës organizative; saktësia e planifikimit dhe materialet mbështetës logjistik; qartësia e pyetjeve dhe mënyra se si janë plotësuar; qartësia e udhëzimeve të stafit në terren; aplikacioni për grumbullimin e të dhënave, duke përfshirë përdorimin e funksioneve ndihmës; përdorimi i aplikacioneve të anketuesve, kontrollorëve dhe mbikëqyrësve; efektiviteti dhe efikasiteti i procedurave të transmetimit të të dhënave; efikasiteti i përzgjedhjes së stafit në terren dhe metoda e rekrutimit; efikasiteti i trajnimit të stafit të terrenit; bashkëveprimi midis të gjitha njësive dhe niveleve të përfshira në Cens; qarkullimi i informacionit ndërmjet të gjitha niveleve; verifikimi dhe konsolidimi i programeve të përpunimit të të dhënave duke përdorur të dhënat e Censit Pilot. Gjatë vitit 2020, do të fillojë puna për kryerjen e një tjetër testi të Cens, qëllimi i të cilit do të jetë testimi i elementeve të ndryshëm bazuar në gjetjet e Censit Pilot të kryer gjatë vitit 2019.

Suksesi i Censit varet në masë të madhe nga angazhimi pozitiv dhe pjesëmarrja e popullatës. Prandaj, gjatë vitit 2020 do të kushtohet një vëmendje e veçantë përditësimit, implementimit dhe monitorimit të strategjisë së komunikimit.

Aktivitetet do të vazhdojnë me përditësimin e zonave specifike në terren të censit (ZC), kryesisht zona të prekuara nga fatkeqësia natyrore (Tërmeti i 26 Nëntorit të 2019) dhe objekte në ndërtim gjatë 2019. Gjithashtu, aktivitetet e hartave të cens në fazën e para-numërimit do të vazhdojnë me: kontrollet e cilësisë të të dhënave të ardhura nga terreni dhe përditësimin e gjeodatabazës, përditësimi i kufijve të Zonave të Censit, gjeokodifikimi i njësive gjeografike, përgatitjen e hartave dixhitale të Zonave të Cens, për të gjithë zinxhirin e stafit të terrenit - anketues, kontrollor dhe mbikëqyrës, krijimin e hartave ”smart” (geodaatabase/map format) sipas kërkesave të Njësive të TI e IT për tu testuar/aksesuar/integruar në aplikacionin e pyetësorëve të censit.

Gjatë vitit 2020 bazuar edhe në gjetjet e Pilotit do të vazhdohet puna në lidhje me zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të Cens. Do të zhvillohen dhe testohen sistemet e TI për pyetësin elektronik si edhe sistemin e monitorimit të procesit të mbledhjeve të të dhënave në terren.

Gjatë këtij viti, do të vazhdojë puna për përmirësimin e pyetësit të Censit si edhe materialeve të tjera shoqëruese, bazuar në gjetjet e Pilot Cens të kryer në 2019 si dhe në situatat e emergjencave të fundit që kanë ndodhur (tërmeti i Nëntorit të 2019 dhe Covid-19). Nga ana tjetër, punë përgatitore do të kryhet edhe nga burimet njerëzore për realizimin e veprimtarive menaxhuese në bashkëpunim me njësitë e tjera dhe stafin e INSTAT-it.

Logjistika do të synojë që të vërë në zbatim dhe monitorojë sa më shumë të jetë e mundur të gjitha procedurat që parashikohen të zhvillohen në Cens (përgatitje materiale, organizim trajnimesh, shpërndarje dhe grumbullim materiale, etj). Një element i rëndësishëm tek i cili do të punohet gjatë vitit 2020 do të jetë edhe vlerësimi i situatës në terren. Kjo parashikon që të zhvillohen takime me pushtetin vendor për të identifikuar sa më saktë mundësitë dhe elementët që do të mund të suportohen nga këto struktura, por njëkohësisht edhe mbledhur informacion dhe vlerësuar nevojat për rastet kur njësitë vendore nuk mund ta suportojnë Censin sipas kërkesave të tij.

B. Censi i Bujqësisë

Cens-i i radhës i Bujqësisë, duke ndjekur rekomandimet e Programit Botëror për Cens-in e Bujqësisë 2020, është planifikuar të kryhet në vitin 2022. INSTAT, gjatë vitit 2019, ka përgatitur një modul pyetjesh, të cilat janë përfshirë në pyetësin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave 2020, me qëllim përditësimin e listës së fermave bujqësore si kornizë për Cens-in e ardhshëm të njësisë ekonomike bujqësore.

Krahas kësaj, janë përcjellur pranë Ministrisë për Evropën dhe Punëve të Jashtme, delegacionit të BE-së në Tiranë si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dy kërkesa zyrtare, në mënyrë që të identifikohen burimet e mundshme financiare për zbatimin e këtij procesi shumë të rëndësishëm për qëllimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë takimit të Donatorëve të organizuar nga INSTAT më 31 Tetor 2019, INSTAT prezantoi kërkesën për mbështetje për "Hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cens-in e Bujqësisë 2022".

Gjatë këtij takimi INSTAT theksoi rëndësinë e zhvillimit të një strategjie, për të planifikuar dhe detajuar elementët më të rëndësishëm të projektit, një plan strategjik, bazuar në ekspertizën e

vendeve evropiane të shoqëruar nga një plan veprimi me përcaktim të qartë të roleve të aktorëve të përfshirë.

INSTAT brenda vitit 2020, do të përgatisë Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Cens-it të Bujqësisë. Zhvillimi i strategjisë për detajuar elementët më të rëndësishëm të projektit si dhe me përcaktim të qartë të roleve të aktorëve të përfshirë ka një rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e të gjithë procesit.

Strategjia do të përshkruajë kërkesat ligjore, teknologjike, operacionale dhe buxhetore për Cens-in e Bujqësisë që do të zhvillohet në 2022. Kjo do të ndihmojë qeverinë dhe parlamentin Shqiptar, si dhe bashkësinë ndërkombëtare të donatorëve për të vendosur mbi angazhimet e tyre për të mbështetur dhe zbatuar Cens-in 2022 gjatë viteve të ardhshëm.

3.3 Analiza e risqeve dhe problemet e pritshme për kryerjen e aktiviteteve.

Secili aktivitet statistikor i parashikuar në Programin Vjetor 2020 dhe pasqyruar në Aneksin 1 të këtij plani, shoqërohet edhe me problematikat dhe nivelin e risqeve të mundshme që mund të ndikojnë në performancën e aktiviteteve. Në vështrimin e përgjithshëm të aneksit, konstatohet se ka një ngjashmëri në tematikat e risqeve të aktiviteteve, pavarësisht fushës apo temës në të cilën ata parashikohen kryesisht në vonesat në transmetimin e të dhënave, cilësinë e informacionit të mbledhur, burimet financiare dhe njerëzore për kryerjen e aktiviteteve dhe lëvizjet e stafit. Pasqyra e mëposhtme paraqet në formë të përmbledhur risqet dhe nivelet e tyre për secilën fushë:

Fusha statistikore	Risku	Niveli i riskut: Risk me nivel të ulët=1-3; Risk me nivel të mesëm=4-6; Risk me nivel të lartë=7-9
1 “Statistikat Demografike dhe Sociale”	Vonesa në procesin e grumbullimit të të dhënave nga burimet administrative	3
	Ardhja e pyetësorëve me vonesë në INSTAT	3
	Dorëheqjet e anketuesve gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave	3
	Vonesa në kontrollin dhe hedhjen e të dhënave.	3
	Shtyrja e publikimit	4
	Mungesa e fondeve për mbulimin e aktiviteteve	9
2 “Statistika Ekonomike”	Vonesa në marrjen e të dhënave nga burimet e informacionit (administrativ ose nga vrojtimet)	5
	Moszbatimi i projektit të Bankës Botërore për përmirësimin e metodologjisë së kontabilitetit drejt bazës	7

	"modified accrual" (të drejta dhe detyrime të konstatuara).	
	Vonesat në raportimet vjetore të treguesve fiskalë dhe të të dhënave kontabël nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme si dhe të rakordimeve me të tretët	6
	Saktësia dhe cilësia e informacionit të raportuar	3
	Procesimi elektronik i saktë nga SIFQ për konsolidimin e të dhënave dhe gjenerimin e raporteve financiare	9
	Trajnimi i përditësuar (i munguar) i kapaciteteve profesionale me përmirësimet e metodologjisë kontabël	7
	Mungesa e stafit të dedikuar për prodhimin e pasqyrave financiare të konsoliduara	5
	Disponibiliteti i të tretëve për bashkëpunim dhe rakordim të të dhënave financiare dhe kontabël	3
	Mosrespektimi i afateve të vrojtimit vjetor për statistikat strukturore të ndërmarrjeve ekonomike në terren;	3
	Mangësi në cilësinë dhe plotshmërinë e informacionit të mbledhur apo hedhur në bazat e të dhënave;	3
	Gabime të bëra nga stafi ekspert gjatë përpunimit dhe nxjerrjes së rezultateve.	3
	Informacion jo i plotë nga të dhënat administrative;	3
3 "Statistikat Sektoriale"	Vonesa në marrjen e të dhënave nga burimet administrative	3
	Vonesa e kryerjes së anketës në terren nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	3
	Gabime të bëra nga stafi ekspert gjatë përpunimit dhe nxjerrjes së rezultateve.	3
	Informacion jo i plotë nga të dhënat administrative	3
	Mosidentifikimi i saktë i burimeve të informacionit	9
	Mungesa e stafit të trajnuar për SDC	
	Probleme me transferimin nëpërmjet ESS Metadata-Handler	3
	Mungesa e stafit përgjegjës në agjencitë e tjera statistikore	3
	Mungesa e investimeve për përditësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës IT	3
	Mungesa e infrastrukturës mbështetëse për përmirësimin e mbrojtjes së të dhënave	3
4 "Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain"	Vonesa dhe cilësia në marrjen e të dhënave nga burimet administrative	3
	Mungesa e burimeve financiare dhe asistencës teknike në kohë për aktivitetet përgatitore të censit	5

	Ndryshime, shtyrje afatesh nga institucioni koordinues (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor)	3
Censi i Popullsisë dhe Banesave	Mungesa e burimeve financiare për realizimin e Censit	7
	Mos-sigurimi i stafit të nevojshëm(kapaciteti dhe aftësitë) për kryerjen e aktivitetit në terren	
	Vonesa për shkak të procedurave të prokurimit	
	Mos-sigurimi i mbulimit të plotë të objektit të Censit	3

Për reduktimin e risqeve, INSTAT ka ndërmarrë një sërë iniciativash të cilat kanë të bëjnë me formalizimin e veprimtarive të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të aktiviteteve statistikore. Gjithashtu, për të reduktuar vonesat në transmetimin e informacionit si dhe për të përmirësuar cilësinë e të dhënave administrative që sigurohen nga institucionet prodhuese, gjatë vitit 2020 INSTAT ka negociuar me institucionet publike marrëveshje mirëkuptimi duke përcaktuar detyra dhe përgjegjësi të qarta ndërinstitucionale, ngritje grupe pune dhe përcaktimin e formave e afateve të transmetimit të të dhënave të nevojshme. Ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e risqeve kanë edhe aktivitetet zbatuese për arritjen e objektivave strategjike të zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, të reflektuara në Seksionin II të këtij dokumenti.

IV. Notë shpjeguese për përdorimin e Aneksit 1

Aneksi 1 i Planit Vjetor 2020 është hartuar sipas klasifikimit të përcaktuar në Shtojcën 1 të ligjit të statistikave zyrtare (Fushë / temë / nëntemë) duke ndjekur përmbajtjen e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021 për çdo modul. Përputhja e moduleve me temën është në linjë me klasifikimin statistikor të Compendium 2017 të Eurostat. Çdo aktivitet statistikor i parashikuar për një temë të caktuar, shoqërohet me kolona të cilat tregojnë:

- Kodi i aktivitetit;
- Emertimi i aktivitetit;
- Periodiciteti;
- Afati i grumbullimit të të dhënave;
- Afati i publikimit të rezultateve;
- Institucionet përgjegjëse për furnizimin me të dhëna;
- Institucioni përgjegjës për aktivitetin;
- Risku i pritshëm;
- Niveli i riskut;
- Burimi financiar për mbulimin e aktivitetit.

Shkurtime "D", "M", "T", "V" dhe "NA" kanë kuptimin përkatësist:

D -Ditë

M - Muaj
T - Tremujor
V - Vit
NA - Nuk aplikohet

Periudhë reference do të thotë periudha së cilës i referohen të dhënat e grumbullara apo rezultatet e publikuara

Shembull I: 1.1.1.1 Statistikat e Popullsisë

Në kolonën “Afati i grumbullimit të të dhënave” rezulton “V+10 D”. Kjo do të thotë se grumbullimi i të dhënave mbyllet 10 ditë pas përfundimit të vitit referencë.

P.sh. Për vitin referencë 2018, afati i grumbullimit të të dhënave është data 10 Janar 2019.

Në kolonën “Afati i publikimit të rezultateve” rezulton “V+42 D”. Kjo do të thotë se rezultatet do të publikohen 42 ditë pas mbylljes së vitit referencë. Nëse viti referencë është 2019, atëherë publikimi i rezultateve do të jetë me 11 Shkurt 2020.

Shembull II: 1.3.1.1 Statistika të regjistrimeve në arsim (regjistrimet në arsimin parauniversitar)

Në kolonën “Afati i publikimit” rezulton “V-14 D”. Kjo do të thotë se rezultatet do të publikohen brenda vitit referencë dhe, konkretisht, për vit referencë 2019-2020 (vite shkollore) rezultatet publikohen më 16 Dhjetor 2020.

Shembull III: 2.3.4.1 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave administrative dhe statistikore për përditësimin e regjistrave të njësisë ekonomike.

Në kolonën “Afati i grumbullimit” rezulton “V-180 D”. Kjo do të thotë se të dhënat grumbullohen brenda vitit referencë dhe, në këtë rast, në 6 mujorin e parë të vitit referencë.

Shembull IV: 4.2.2 Inventarizimi i numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre

Në kolonën “ Afati i grumbullimit” rezulton “V”. Kjo do të thotë se të dhënat do të grumbullohen gjatë gjithë vitit referencë.

V. Aneksi 1

Aktivitetet statistikore për vitin 2020, sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021